

LIGJ
Nr.7423, datë 13.11.1990

PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT POPULLOR

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës

KUVENDI POPULLOR I REPUBVLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Zgjedhjet për deputetët e Kuvendit Popullor bëhen me votim të përgjithshëm, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në bazë të vullnetit të lirë të zgjedhësve.

Çdo presion ose formë tjetër detyrimi që pengon shprehjen e lirë të vullnetit të shtetasve gjatë ushtrimit të së drejtës të zgjedhjes dënohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 2

Kanë të drejtë të marrin pjesë në zgjedhje dhe të zgjidhen deputetë në Kuvendin Popullor shtetasit shqiptarë që ditën e zgjedhjeve mbushin moshën 18 vjeç.

Nga e drejta e zgjedhjes përjashtohen vetëm ata shtetas, të cilëve u është hequr kjo e drejtë me vendim të gjykatës për shkak se kanë kryer një vepër penale, të paafët mendërisht, të cilëuar si të tillë nga gjykata, ata që janë duke vuajtur dënimin me heqje lirie, si dhe të arrestuarit me vendim të gjykatës apo me miratim të prokurorit.

KREU II
LISTAT E ZGJEDHËSVE

Neni 3

Zgjedhjet bëhen në bazë të listave të zgjedhësve.

Në listat e zgjedhësve regjistrohen të gjithë shtetasit që gëzojnë të drejtën e votës dhe banojnë (përherë ose përkohësisht) në territorin e një këshilli popullor në kohën e hartimit të listave.

Çdo shtetas regjistrohen vetëm në një listë zgjedhjeve.

Neni 4

Listat e zgjedhësve harrohen për çdo qendër votimi sipas formës së caktuar. Në qytete ato hartohen nga komitete ekzekutive të këshillave popullorë të qyteteve ose nga këshillat popullorë të qyteteve kur nuk kanë komitet ekzekutiv; në qytetet që janë ndarë në lagje nga këshillat popullorë të lagjeve dhe në fshatra nga këshillat popullorë të fshatrave.

Listat e zgjedhësve shpallen nga komitetet ekzekutive ose nga këshillat popullorë që i kanë hartuar, jo më vonë se 25 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 5

Listat për zgjedhësit që shërbejnë dhe banojnë në njësitë e repartit ushtarakë, hartohen dhe shpallen nga komandat e tyre. Të gjithë ushtarakët e tjerë regjistrohen në listat e zgjedhësve të vendbanimit të tyre të hartuara nga komitetet ekzekutive ose këshillat popullorë përkatës.

Neni 6

Kur një zgjedhës për arsye të ndryshme largohet nga vendbanimi pas shpalljes së listës së zgjedhësve dhe para ditës së zgjedhjeve, me kërkesën e tij, komiteti ekzekutiv ose këshilli popullor që ka shpallur listën i lëshon një “vërtetim të drejtë vote” dhe në listën e zgjedhësve shënon fjalën “larguar”.

Zgjedhësi regjistrohet në listën e zgjedhësve të vendbanimit të ri (të përhershëm ose të përkohshëm) me të paraqitur vërtetimin e së drejtës së votës bashkë me letërnjoftimin e tij ose ndonjë dokument tjetër që e zëvendëson atë.

Në Çdo qendër votimi mund të votojnë me vërtetim të drejtë vote jo më tepër se 1/15 e zgjedhësve të regjistruar.

Listat e zgjedhësve prë shtetasit shqiptarë që kanë shkar përkohësisht jashtë shtetit, hartohen sipas mënyrë së caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 7

Organi që ka shpallur listat e zgjedhësve, me vendim, mund të bëjë ndryshime në këto lista edhe ditën e zgjedhjeve, por, në çdo rast, para fillimit të votimit, kur një shtetas ka vdekur, është regjistruar 2 herë, nuk figuron i regjistruar, nuk gëzon të drejtën e zgjedhjes ose ndodhet jashtë territorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 8

Çdo shtetas ka të drejtë të bëjë kërkesë për ndreqjen e gabimeve e të mangësive në listat e zgjedhësve si mungesë regjistrimi, heqje nga lista, ndryshime në emër ose mbiemër, regjistrim i personave që kanë humbur të drejtën e zgjedhjes etj. Kërkesa bëhet nga organi që ka shpallur listat, i cili detyrohet ta shqyrtojë atë brenda dy ditëve dhe të japë vendimin përkatës.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit, e cila brenda 3 ditëve në prani të ankuesit dhe të përfaqësuesit të organit që ka shpallur listat, shqyrton ankimin në seancën gjyqësore me dyer të hapura dhe merr vendimin përaktës. Vendimi gjyqësor është i formës së prerë.

KREU III ZONAT E ZGJEDHJEVE DHE QENDRAT E VOTIMIT

Neni 9

Për zgjedhjen e Kuvendit Popullor krijohet 250 zona zgjedhjeje me numër afërsisht të barabartë banorësh.

Zonat e zgjedhjeve caktohen dhe shallen nga Prsidiumi i Kuvendit Popullor jo në vonëse 40 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 10

Territori i çdo qyteti, lagjeje qyteti dhe fshati ndahet në qendra votimi.

Për çdo 100 deri në 600 zgjedhës ngrihet një qendër votimi.

Kur një qendër une sëhtë larg nga qendra më e afërt e votimit më shumë se 3 km, aty ngrihet qendër votimi e veçantë në qoftë se ka së paku 50 zgjedhës.

Neni 11

Qendrat e votimit caktohen me vendim jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve. Në qytete ato caktohen nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të qyteteve ose nga këshillat popullore të qyteteve kur nuk kanë komitetet ekzekutiv, në qytetet që janë narë në lagje nga këshillat popullore të lagjeve dhe në fshatra nga këshillat popullore të fshatrave.

Neni 12

Në njësitë dhe repartet ushtarake për çdo 20 gjer 600 zgjedhës ngrihet një qendër votimi e veçantë. Këto qendra votimi hyjnë në zonën e zgjedhjeve në territorin e së cilës ndodhet njësia ose reparti ushtarak.

Qendrat e votimit në njësitë ose repartet ushtarake caktohen me vendim të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore ose të këshillave popullore kur nuk kanë komitet ekzekutiv në territorin e të cilëve ndodhet njësia ose reparti ushtarak. Ato u bëhen të njohura zgjedhësve dhe kandidatëve të tyre.

Neni 13

Në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit që kanë jo më pak se 5 zgjedhës ngrihen qendra votimi të veçanta, të cilat hyjnë në një nga zonat e zgjedhjeve të qytetit të Tiranës.

Në anijet që ditën e zgjedhjeve ndodhen në udhëtim, ngrihen qendra votimi të veçanta, në qoftë e kanë jo më pak se 5 zgjedhës. Këto qendra votimi hyjnë në një nga zonat e zgjedhjeve të vendit ku është regjistruar anija.

Neni 14

Në spitale, shtëpi lindjeje dhe institucione të tjera si këto ngrihen qendra votimi në qoftë se kanë më shumë se 15 zgjedhës.

Neni 11

Qendrat e votimit caktohen me vendim jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve. Në qytete ato caktohen nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të qyteteve ose nga këshillat popullore të qyteteve kur nuk kanë komitete ekzekutiv, në qytetet që janë ndarë në lagje nga këshillat popullore të lagjeve dhe në fshatra nga këshillat popullore të fshatrave.

Neni 12

Në njësitë dhe repartet ushtarake për çdo 20 gjer 600 zgjedhës ngrihet një qendër votimi e veçantë, Këto qendra votimi hyjnë në zonën e zgjedhjeve në territorin e së cilës ndodhet njësia ose reparti ushtarak.

Qendrat e votimit në njësitë ose repartet ushtarake caktohen me vendim të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore ose të këshillave popullore kur nuk kanë komitet ekzekutiv në territorin e të cilëve ndodhet njëzia ose reparti ushtarak. Ato u bëhen të njohura zgjedhësve dhe kandidatëve të tyre.

Neni 13

Në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit që kanë jo më pak se 5 zgjedhës ngrihen qendra votimi të veçanta, të cilat hyjnë në një nga zonat e zgjedhjeve të qytetit të Tiranës.

Në anijet që ditën e zgjedhjeve ndodhen në udhëtim, ngrihen qendra votimi të veçanta, në qoftë se kanë jo më pak se 5 zgjedhës. Këto qendra votimi hyjnë në një nga zonat e zgjedhjeve të vendit ku është regjistruar anija.

Neni 14

Në spitale, shtëpi lindjeje dhe institucione të tjera si këto ngrihen qendra votimi në qoftë se kanë më shumë se 15 zgjedhës.

Në institucone që kanë shumë pavione mund të ngrihet një qendër votimi e veçantë për çdo pavion, në qoftë se secili pavion ka më shumë se 15 zgjedhës.

KREU IV KOMISIONET E ZGJEDHJEVE

Neni 15

Për drejtimin e zgjedhjeve të Kuvendit Popullor ngrihen këto komisione: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, komisionet e zgjedhjeve të zonave dhe komisionet e qendrave të votimit.

Në komisionet e zgjedhjeve marrin pjesë përfaqësues të organizatave ppolitike e shoqërore, përfaqësues të shqatave të ndryshme dhe personalitete të shquara të fushave të ndryshme.

Zëvendëskryetari ose sekretari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe kryetarët ose sekretarët e komisioneve të zgjedhjeve të zonave duhet të jenë juristë.

Neni 16

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga krytari, zëvendëskryetari, sekretari dhe 10 anëtarë. Komisioni miratohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor jo më vonëse 40 ditë përpara zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kryen sidomos këto detyra:

- a) Kujdeset për zbatimin e përiktë të ligjit mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor gjatë zhvillimit të zgjedhjeve në të gjithë territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
- b) regjistron deputetët e zgjedhur në Kuvendin Popullor.
- c) shqyrton ankimet kundër veprimeve të parregullta të komisioneve të qendrave të votimit;
- d) i lëshon deputetit të zgjedhur vërtetimin e zgjedhjes së tij;
- e) i dërgon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve aktet e zgjedhjeve.

Neni 17

Në çdo zonë zgjedhjeje ngrihet komisioni i zgjedhjeve i zonës i përbërë nga një kryetar, një sekretar dhe tre anëtarë. Komisioni miratohet me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit jo më vonë se 25 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Komisioni i zgjedhjeve i zonës kryhen këto detyra:

- a) Kujdeset për zbatimin e përiktë të ligjit mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor gjatë zhvillimit të zgjedhjeve në të gjithë territorin e zonës;
- b) regjistron dhe shpall kandidatët për deputetë, të paraqitur sipas këtij ligji;
- c) numëron votat në mbështetje të procesverbaleve të qendrave të votimit dhe shpall përfundimet e zgjedhjeve në zonë;
- ç) shqyrton ankimet kundër veprimeve të parregullta të komisioneve të qendrave të votimit;
- d) i lëshon deputetit të zgjedhur vërtetimin e zgjedhjes së tij;
- e) i dërgon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve aktet e zgjedhjeve.

Neni 18

Për çdo qendër votimi ngrihet komisioni i qendrës së votimit i përbërë nga një kryetar, një sekretar dhe tre anëtarë. Komisioni miratohet me vendim, jo në vonë se 25 ditë nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të qyteteve ose nga këshillat popullore të qyteteve kur nuk anë komitet ekzekutiv. Në qytetet që janë ndarë kur nuk kanë këshillat popullore të lagjeve dhe në fshatra nga këshillat popullor të fshatrave.

Komisioni i qendrës së votimit kryen këto detyra:

- a) drejton dhe kontrollon veprimtarinë për zbatimin e ligjit mbi zgjedhjet në qendrën e votimit;
- b) numëron votat e hedhura për çdo kandidat për deputet;
- c) regjistron në procesverbal të gjitha ankesat, kërkesat, vërejtjet dhe propozimet e zgjedhësve ose kandidatëve, i shqyrton ato dhe merr vendimin përkatës;
- ç) i dorëzon komisionit të zgjedhjeve të zonës procesverbalin e votimit;
- d) i dërgon për ruajtje komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të qytetit aktet e zgjedhjeve.

Neni 19

Kandidati për deputet nuk mund të jetë anëtar i komisionit të zgjedhjeve të zonës dhe as i komisioneve të qendrave të votimit të zonës ku është vendosur kandidatura e tij.

Neni 20

Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve të zonave ose të qendrave të votimit mund të lirohen nga detyra e tyre në këto komisione, prej organit që ka miratuar përbërjen e komisionit, me kërkesën e vetë anëtarëve ose me propozim të organizatave apo shoqatave.

Neni 21

Drejtuesit e ndërmarrjeve, të institucioneve dhe të organizatve shoqërore ose ekonomike detyrohen të lejojnë shkëputjen nga puna kundrejt pagesës së kryetarëve e sekretarëve të komisioneve të zgjedhjeve të zonave, tri ditë para votimit dhe dy ditë pas votimit, si dhe të kryetarëve e sekretarëve të komisioneve të qendrave të votimit, tri ditë para votimit dhe një ditë pas votimit.

KREU V PARAQITJA E KANDIDATËVE

Neni 22

Për çdo zonë zgjedhjeje për deputetë në Kuvendin Popullor paraqiten jo më pak se dy kandidatë.

Një person mund të jetë kandidat për deputet vetëm në një zonë zgjedhjeje.

Mund të paraqitet kandidat për deputet shtetasi shqiptar që ka vendbanim të përhershëm në territorin e RPSSH.

Neni 23

Kanë të drejtë të paraqesin kandidatë për deputetë në Kuvendin Popullor organizatat politike e shoqërore: Partia e Punës e Shqipërisë, Fronti Demokratik, Bashkimet Profesionale, Bashkimi i Grave, Bashkimi i Rinisë, Komiteti Kombëtar i Veteranëve, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, si dhe çdo organizatë ose shoqatë tjetër politike e shoqërore e njohur me ligj.

Neni 24

Çdo organizatë ose shoqatë ka të drejtë të paraqesë jo më tepës se një kandidat për çdo zonë zgjedhjeje.

Organizatat dhe shoqatat mund të paraqesin edhe bashkërisht të njëjtët kandidatë.

Neni 25

Çdo shtetas ka të drejtë të paraqesë kandidaturën për t'u zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor, pasi të ketë siguruar miratimin e jo më pak se 300 zgjedhësve të zonës përkatëse.

Neni 26

Sipas traditës e vijës së masave, për kandidatët e propozuar nga organizatat dhe shoqatat, përpaa se të bëhet regjistrimi i tyre tërhiqet edhe mendimi i popullit në mbledhje të hapura që organizohen për këtë qëllim sipas zonave përkatëse.

Në këto mbledhje zgjedhësit kanë të drejtë t'u propozuar nga organizatat dhe shoqatat, përpara se të bëhet regjistrimi i tyre tërhiqet edhe mendimi i popullit në mbledhje të hapura që organizohen për këtë qëllim sipas zonave përkatëse.

Zgjedhësit që marrin pjesë në mbledhjet për diskutimin paraprak të kandidaturave, kanë të drejtë të propozojnë edhe drejtpërsëdrejti nga këto mbledhje kandidatë për deputetë në Kuvendin Popullor.

Propozimet për heqjen ose paraqitjen e në kandidati për deputet miratohen nga shumica e pjesëmarrësve në mbledhjet e zgjedhësve, me votim të hapur.

Neni 27

Organet qendrore të organizatave ose të shoqatave, pasi kanë marrë edhe vërejtjet e propozimet në mbledhjet paraprake të zgjedhësve, përpilojnë veçmas ose së bashku listën përfundimtare të kandidatëve për deputetë që do të paraqesin në rrethin përkatës.

Kur lista është e përbashkët shpallet nga Fronti Demokratik duke cilësuar edhe organizatën ose shoqatën propozuese, të cilës i përket kandidati i paraqitur.

Neni 28

Kandidatët për deputetë në Kuvendin Popullor duhet të regjistrohen në komisionin e zgjedhjeve duhet të regjistrohen në komisionin e zgjedhjeve të zonës jo më vonë se 15 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Për të bërë regjistrimin paraqiten këto dokumente:

a) Kërkesa me shkrim nga organizata ose shoqata përkatëse në të cilën kërkohet regjistrimi i kandidatit të paraqitur për deputet. Kërkesa duhet të përmbajë emrin, atësinë, mbiemrin dhe moshën e kandidatit.

Kur kandidatura është vënë nga vetë kandidati, paraqitet kërkesa me nënshkrimet përkatëse të zgjedhësve. Komisioni ka të drejtë të bëjë verifikime për vërtetësinë e nënshkrimeve të zgjedhësve.

b) Deklarata e kandidatit që pranon vënien e kandidaturës së tij në atë zonë të zgjedhjeve.

Neni 29

Komisionet e zgjedhjeve të zonave, kur janë plotësuar kushtet e këtij ligji, detyrohen të regjistrojnë të gjithë kandidatët për deputetë në Kuvendin Popullor dhe të bëjnë shpalljen e tyre jo më vonë se 15 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, duke shënuar edhe emrin e organizatës ose shoqatës që e ka paraqitur.

Neni 30

Për çdo kandidat për deputet komisioni i zgjedhjeve të zonës mban një procesverbal regjistrimi sipas formës së caktuar. Një kopje e këtij procesverbali i dërgohet menjëherë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bahskë me deklaratën e kandidatit që pranon vënien e kandidaturës së tij në atë zonë.

Neni 31

Kundër vendimit të komisionit të zgjedhjeve të zonës që nuk pranon të regjistrojë ose që ka regjistruar një kandidat për deputet në Kuvendin Popullor mund të bëhet ankim dhe brenda 3 muajve jep vendimin e formës së prerë, të cilin e shpall menjëherë.

Neni 32

Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të bëhet ankim në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, pasi thërret kandidatin dhe përfaqësuesin e komisionit përkatës të zonës, shqyrton ankimin dhe brenda 3 ditëve jep vendimin e formës së prerë, të cilin e shpall menjëherë.

Neni 33

Kur një kandidat për deputet në Kuvendin Popullor hiqet nga propozuesit, tërheq kandidaturën e vet ose vdes mbasi është regjistruar nga komisioni i zgjedhjeve, organizata ose shoqata përkatëse mund të regjistrojë një kandidat tjetër, por jo më vonë se 7 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 34

Kur kandidasti për deputet hiqet nga propozuesit, tërheq kandidaturën e vet, vdes ose kryen një krim të dukshëm e të rëndë gjatë periudhës 7 ditë përpara zgjedhjeve dhe në atë zonë janë vendosur jo më tepër se dy kandidatura, organi që ka bërë regjistrimin heq emrin e kandidatit nga lista e paraqitur ose fleta e votimit dhe zgjedhjet për atë zonë bëhen në një ditë tjetër jo më vonë se dy javë nga dita e zgjedhjeve të përgjithshme.

KREU VI

TË DREJTAT DHE DETYRAT E KANDIDATËVE GJATË FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE

Neni 35

Organizatat ose shoqatat që kanë paraqitur kandidatë, si dhe çdo kandidat i pavarur duhet të paraqesin publikisht programin përkatës me shrim ose me gojë.

Programet e paraqitura nuk duhet të përmbajnë ide fashiste, raciste, terroriste ose ide të frymëzuara apo të huajtura nga organizatat tradhtare të krijuara gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

Neni 36

Çdo organizatë, shoqatë e individ ka të drejtë të barbaartë të bëjë propagandë për kandidatin e regjistruar, në mbledhje, në shtëpi, në radio, në televizion dhe në mënyra të tjera.

Neni 37

Ndalohet që kandidati për deputet të përdorë mjetet e informacionit të vendeve të huaja për propagandë gjatë fushatës së zgjedhjeve.

Neni 38

Institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat detyrohen të ndihmojnë e të krijojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin normalisht të propagandës, për takimet e të gjithë kandidatëve me zgjedhësit, si dhe t'iu vënë në dispozicion materialet e nevojshme për njohjen e gjendjes.

Neni 39

Gjatë fushatës së zgjedhjeve nuk lejohet asnjë lloj propagande nga organet e pushtetit dhe të administratës shtetërore për kandidatët e paraqitur për deputetë në Kuvendin Popullor.

Neni 40

Shteti u jep ndihmën e nevojshme kandidatëve ose organizatave që nuk kanë mjete materiale e të ardhura financiare të mjaftueshme për përballimin e fushatës së zgjedhjeve.

Burimet e financimit të fushatës së zgjedhjeve kontrollohen nga shteti.

Neni 41

Ndalohet që kandidati për deputet të marrë për fushatën e zgjedhjeve ndihma. Dhurata ose mjete financiare nga shtete dhe nga persona të huaj fizikë ose juridikë, të blejë vota nga zgjedhësit si

dhe të përhapë të dhëna të rreme për kandidatët e tjerë.

Neni 42

Për shkeljen e rregullave të prashikuara nga nenet 35, 37, 39 dhe 41 të këtij ligji, kandidati për deputet çrregjistrohet nga lista e kandidatëve prej komisionit që ka bërë regjistrimin e tij dhe, kur shkelja formon vepër penale, përgjigjet sipas dispozitave të parashikura në Kodin Penal.

Neni 43

Kandidatëve për deputetë në Kuvendin Popullor u ruhet vendi i punës dhe u jepet pagë e plotë kur kryejnë detyrat si kandidatë gjatë fushatës së zgjedhjeve.

Neni 44

Kandidatët për deputetë në Kuvendin Popullor nuk mund të merren në përgjegjësi penale. Të arrestohen ose të ndalohen pa miratimin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, përveç rasteve kur kryejnë një krim të dukshëm e të rëndë.

KREU VII VOTIMI

Neni 45

Zgjedhjet e Kuvendit Popullor bëhen në një ditë pushimi në të gjithë Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Data e zgjedhjeve caktohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor jo më vonë se 2 muaj përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 46

Votmi bëhet ditën e caktuar për zgjedhjet prej orës 6.00 deri në orën 20.00.

Neni 47

Ditën e zgjedhjeve, para orës 6.00, kryetari i komisionit të qendrës së votimit, në prani të anëtarëve të këtij komisioni, kontrollon kutitë e votimit e listën e zgjedhësve dhe, pasi i gjen këto në rregull, mbyll e vulos kutitë e votimit, si dhe fton zgjedhësit të fillojnë votimin.

Kryetari i komisionit të qendrës së votimit është përgjegjës për mbajtjen e rregullit dhe të qetësisë në qendrën e votimit. Urdhrat e tij janë të detyrueshëm për të gjithë.

Neni 48

Gjatë ditës së votimit nuk lejohet asnjë propagandë për kandidatët.

Neni 49

Në çdo qendër votimi caktohen për zgjedhësit dhoma ose të ndara të fshehtësisë. Në këto vende është e ndaluar prania e çdo personi, duke përfshirë dhe anëtarët e komisionit të qendrës së votimit.

Neni 50

Çdo zgjedhës voton vetë duke u paraqitur në qendrën e votimit dhe duke u futur detyrimisht në dhomën ose të ndarën e fshehtësisë.

Zgjedhësi ka të drejtë të votojë për kandidatin që dëshiron.
Votomi bëhet duke hedhur fletën e votimit në kutinë e votimit.

Neni 51

Zgjedhësi që, për shkak se është sëmure ose për çdo shkak tjetër nuk ka mundësi që të paraqitet vetë në qendrën e votimit, ka të drejtë të kërkojë që komisioni i qendrës së votimit t'i dërgojë për të votuar, me një anëtar të komisionit, kutinë e dytë të votimit që ndodhet në çdo qendër votimi.

Neni 52

Zgjedhësi që nuk di shkrim e këndim ose ka ndonjë të metë trupore, ka të drejtë të thërrasë për ndihmë në dhomën e ose të ndarën e fshehtësisë çdo zgjedhës tjetër.

Neni 53

Fletët e votimit shtypen sipas modelit të caktuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.
Fletët e votimit mund të shtypen edhe në gjuhën e pakicave kombtëare.

Neni 54

Personat që paraqiten për të votuar me vërtetim të drejtë vote të lëshuar sipas këtij ligji, regjistrohen në fund të listës së zgjedhësve ng akomisioni i qendrës së votimit.

KREU VIII VËRTETIMI I PËRFUNDIMIT TË ZGJEDHJEVE

Neni 55

Në orën 20.00 të ditës së zgjedhjeve, kryetari i komisionit të qendrës së votimit e shpall votimin të mbyllur dhe komisioni mban procesverbal për numrin e fletëve të votimit që janë të papërdorura. Pas këtij veprimi hapet kutia e votimit.

Neni 56

Gjatë numërimit të votave nga omisioni i qendrës së votimit dhe nga komisioni i zgjedhjeve të zonës, kanë të drejtë të ndodhen të pranishëm përfaqësuesit e organizatave shoqërore dhe të shoqatave të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim nga organet e tyre, si dhe përfaqësuesit e kandidatëve të pavarur të shtypit, të radiotelevizionit e të agjencisë së lajmeve.

Neni 57

Komisioni i qendrës së votimit krahason numrin e fletëve të votimit të hedhura në kutinë e votimit me numrin e zgjedhësve që kanë marrë fletë votimi në bazë të listës së zgjedhësve dhe numëron votat për secilin kandidat. Përfundimet i shënon në procesverbalin e votimit.

Kryetari i komisionit të qendrës së votimit në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit shpall përfundimet e votimit për çdo kandidat.

Neni 58

Fletët e votimit janë të pavlefshme:

- a) kur fleta e votimit nuk është e modelit të caktuar;
- b) kur në fletën e votimit janë lënë më shumë se një kandidat;
- c) kur prishen emrat e kandidatëve dhe në vend të tyre nuk vihet asnjë person tjetër;
- ç) kur prishen emrat e kandidatëve dhe në vend të tyre vihet një tjetër, por pa shënuar atësinë;

d) kur prishen emrat e kandidatëve dhe në vend të tyre shënohet një person tjetër që nuk ka të drejtë vote, është i mitur, i vdekur etj.

dh) kur fleta e votimit është e njollosur aq shumë sa nuk kuptohet se ç'Veprim është bërë në të.

Neni 59

Komisioni i qendrës së votimit mban një procesverbal votimi sipas formës së caktuar, i cili pasi nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i komisionit i dërgohet menjëherë komisionit të zgjedhjeve të zonës.

Aktet e tjera të zgjedhjeve komisioni i qendrës së votimit të fshatit ia dërgon për ruajtje komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, ndërsa komisioni i qendrës së votimit të lagjes ia dërgon për ruajtje këshillit popullor të qytetit ose komitetit ekzekutiv të tij apo komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rajonit.

Neni 60

Komisioni i zgjedhjeve i zonës numëron votat në bazë të procesverbaleve të votimit të dërguara nga komisinete qendrave të votimit dhe vërteton numrin e voave të hedhura për çdo kandidat për deputet.

Neni 61

Komisioni i zgjedhjeve i zonës mban një procesverbal në dy kopje, që nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i komisionit.

Një kopje e procesverbalit i dërgohet menjëherë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kopja e dytë e procesverbalit së bashki me aktet e tjera të zgjedhjeve i dërgohen për ruajtje komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të qytetit.

Neni 62

Mbas mbarimit të numërimit të votave dhe nënshkrimit të procesverbalit, kryetari i komisionit të zgjedhjeve të zonës shpall në mbledhje të komisionit përfundimin e zgjedhjeve.

Neni 63

Kryetari i komisionit të zgjedhjeve të zonës i lëshon kandidatit të zgjedhur një vërtetim për zgjedhjen e tij si deputet i Kuvendit Popullor.

Neni 64

Quhet i zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor, kandidati që në turin e parë ka fituar më tepër se gjysmën e gjitha votave të hedhura në zonën e zgjedhjeve (shumicën absolute) dhe të njohura të vlefshme.

Neni 65

Kur në zonën e zgjedhjeve janë e regjistruar dy ose më shumë kandidatë dhe asnjëri prej tyre nuk ka marrë në turin e parë shumicën absolute të votave, komisioni i zgjedhjeve e shënon këtë procesverbal dhe njëkohësisht urdhëron zhvillimin e zgjedhjeve në turin e dytë jo më vonëse një javë nga votimi i parë.

Neni 66

Kur në listë janë vënë më tepër se dy kandidatë, në turin e dytë do të votohet për dy kandidatët që kanë marrë më tepër vota, ndërsa, kur në listë kanë qenë vetëm dy kandidatë, kalojnë që të dy në

turin e dytë. Në të dy rastet, për të kaluar në turin e dytë kërkohet që kandidati të ketë marrë më tepër se 5 për qind të votave të vlefshme të hedhura në kutinë e votimit.

Në përfundim të votimit të dytë zgjidhet kandidati që ka marrë më shumë vota se kandidati tjetër (shumicën relative) dhe të njohura të vlefshme.

Kandidatët regjistrohen brenda 4 ditëve nga përfundimi i votimit të parë.

Neni 67

Bëhen zgjedhje të tjer me kandidatë të rinj:

1.Kur në votimin e parë asnjëri nga kandidatët e paraqitur nuk ka fituar më tepër se 25 për qind të votave të vlefshme;

2.Kur në votimin e parë vetëm njëri nga kandidatët e paraqitur ka fituar më tepër se 25 për qind të votave të vlefshme. Ky kandidat mbahet edhe në zgjedhjet e reja.

Zgjedhjet me kandidatë të rinj bëhen jo më vonë se dy javë nga përfundimi i votimit të parë.

Neni 68

Në qoftë se numri i votave të hedhura në një zonë të zgjedhjeve është më i vogël se gjysma e numrit të zgjedhësve që kanë të drejtë të votojnë në atë zonë, komisioni i zgjedhjeve të kësaj zone e shënon këtë procesverbalin e tij dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve jo më vonë se dy javë nga votimi i parë.

Zgjedhjet e reja bëhen në bazë të listave të zgjedhësve të hartuara për zgjedhjet e para dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 69

Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për rezultatet e zgjedhjeve, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Lartë nga kandidati i interesuar. Kjo e shqyrton ankimin dhe brenda 3 ditëve jep vendim të formës së prerë. Vendimi i bëhet i njohur Komisionit të Mandateve të Kuvendit Popullor.

Neni 70

Në rast se vendi i një deputeti të Kuvendit Popullor mbetet i lirë, Presidiumi i Kuvendit Popullor brenda 3-muajve cakton zgjedhjet për një deputet të ri në zonën përkatëse të zgjedhjeve.

KREU I X DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 71

Ligji nr.4121, datë 17.3.1966 “Mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor”, shfuqizohet.

Neni 72

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA